



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 16518 Prot.

Lezhë, më 14 . 09 . 2020

V E N D I M

Nr 127 , Datë 11 / 09 / 2020

Për përdorimin e fondit të kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparshikuara në buxhetin e vitit 2020

Në mbështetje të nenin 54 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1.Miratimin e përdorimit të fondit të kontigjencës në shumën 1,296,490 lekë për supervizim dhe kolaudim të objekteve :

1/1.Rikonstruksion i Gjimnazit të Vjetër, Lezhë në shumën 351,450 lekë (supervizimi me vlerë 313,795 lekë dhe kolaudimi me vlerë 37,655 lekë).

1.2.Rehabilitim i kanalit ujitës Kotërr-Rraboshtë në shumën 945,040 lekë (supervizion-mbikqyrje).

Për këtëbëhen këto ndryshime në programet buxhetore si më poshtë;

a.Pakësohet: -Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art./llog.ek. 604 për shumën 1,003,883 lekë.

-Gr.00, Prog.01110, Kap.05, Art./llog.ek. 604 për shumën 292,607 lekë.

b.Shtohet: -Gr.00, Prog.04240, Kap.01, Art./llog.ek.231 për shumën 652,433 lekë.

-Gr.00, Prog.04240, Kap.05, Art./llog.ek.231 për shumën 292,607 lekë.

-Gr.00, Prog.09230, Kap.01, Art./llog.ek.231 për shumën 351,450 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

